

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika (2) të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Grupi Modirum OU, me seli në Qarkun Harju, Tallin, zona Keklina, zona Parnu 139e/2, 11317, Estoni, përmes Shoqërisë së Avokatëve Papazoski dhe Mishev nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 31.05.2024, miratoi këtë

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi, me të cilin Grupi Modirum OU, me seli në Qarkun Harju, Tallin, zona Keklina, zona Parnu 139e/2, 11317, Estoni, do të fitojë kontroll mbi Shoqërinë për programim kompjuterik dhe shërbime konsulente ITgma SHPK Shkup ITgma SHPK Shkup, me seli në rr. Ankara nr. 29A, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, përmes blerjes së një pjese, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose prishjen e konsiderueshme të konkurrencës efektive në treg ose në pjesën thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës sipas nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 16.05.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim i përqendrimit nga Grupi Modirum OU, me seli në Qarkun Harju, Tallin, zona Keklina, zona Parnu 139e/2, 11317, Estoni, me të cilin Grupi Modirum OU do të fitojë kontroll mbi Shoqërinë për programim kompjuterik dhe shërbime konsulente ITgma SHPK Shkup ITgma SHPK Shkup, me seli në rr. Ankara nr. 29A, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, përmes blerjes së një pjese.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim, shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Grupi Modirum Grupi OU kryen aktivitete të biznesit dhe të këshillimit për menaxhimin e kompanive brenda grupit Modirum, konkretisht kryen aktivitete të zyrës kryesore, aktivitete

këshilluese dhe të menaxhimit dhe aktivitete të tjera afariste dhe këshilluese dhe të menaxhimit. Shoqëri të tjera nga grupi gjithashtu kryejnë punë këshilluese kompjuterike.

Grupi Modirum është i pranishëm në tregun e Maqedonisë së Veriut përmes këtyre Shoqërive:

- Shoqëria për Prodhim, Tregti dhe Shërbime VEB FAKTORI SHPK Shkup, me seli në bul. Brigada e Tretë Maqedonase nr. 56, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, shoqëri që zhvillon softuer dhe ofron shërbime të tjera IT; dhe
- Shoqëria për Marketing dhe Shërbime LAJTHAUS UAN SHPK Shkup, me seli në bul. Brigada e Tretë Maqedonase nr. 56, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut shoqëri që kryen aktivitete marketingu.

Shoqëria për programim kompjuterik dhe shërbime konsulente ITgma SHPK Shkup operon në industrinë IT, konkretisht në fushën e aktiviteteve të këshillimit kompjuterik, programimit kompjuterik dhe shërbimeve të tjera të ngjashme IT. Ajo ofron shërbime softuerike dhe IT në disa industri, si: telekomunikacioni, bankat dhe financat, shërbime softuerike dhe IT, sektori publik dhe qeveritar.

Shoqëria për programim kompjuterik dhe shërbime konsulente ITgma SHPK ka themeluar tri shoqëri të tjera në 100% pronësi, të cilat janë:

- Shoqëria për Programim dhe Shërbime Konsulente ITgma Sourcing SHPKNJP Shkup, me adresë në rr. Ankara nr. 29A, 1000 Shkup, Maqedonia Veriore;
- ITgma SHPK Beograd-Novi Beograd, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe me seli në Republikën e Serbisë; dhe
- **ITgma EMEA FZ LL**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe me seli në Emiratet e Bashkuara Arabe.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска